



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.43

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.230, datë 19.4.2006	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagës të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, ndryshuar.....	të 1331
Vendim i KM nr.231, datë 19.4.2006	Për kompensimin në vlerë të ushqimit të punonjësve të Policisë Burgjeve.....	1334 së
Vendim i KM nr.232, datë 19.4.2006	Krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA).....	1335
Vendim i KM nr.233, datë 19.4.2006	Për miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, për vitin 2006.....	1339
Vendim i GJL nr.1, datë 31.1.2006	Me objekt rishikimin e vendimit civil nr.199, datë 26.3.2001 të Gjykatës së Rrethit Sarandë, lënë në fuqi me vendimin nr.374, datë 17.7.2001 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe lënë në fuqi me vendimin nr.483, datë 4.3.2003 të Gjykatës së Lartë.....	1340
Vendim i GJL nr.3, datë 3.2.2006	Me objekt kthimin e sendit, kati përdhe, çregjistrimin e tij në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nga emri i së paditurës Hajrie Mullai, nxjerrjen e saj jashtë nga sipërfaqja e banesës së pushtuar me dhunë pa qenë pronare, detyrimin e saj të paguajë dëmin e shkaktuar dhe qiranë deri ditën që do të lirojë objektin.....	1350

VENDIM
Nr.230, datë 19.4.2006

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS TË PUNONJËSVE MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) Pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Mësuesit e matematikës, fizikës dhe të informatikës në shkollat e mesme dhe mësuesit e matematikës dhe fizikës në shkollat 8-vjeçare, me diplomë universitare në degët matematikë, fizikë dhe informatikë, përfitojnë një shtesë për kushte pune, në masën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë në muaj.”.

b) Lidhja nr.1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr.2 “Paga e grupit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Lidhja nr.3 “Shpërblimi mujor për punonjësit mësimorë në arsimin parauniversitar, që punojnë larg vendbanimit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pagat e punonjësve të sistemit të arsimit parauniversitar, duke filluar nga data 15 prill 2006, rriten mesatarisht 17 për qind.

3. Paga e trembëdhjetë, që shpërndahej në fund të vitit, bëhet pjesë e pagës mujore të punonjësve mësimorë, të sistemit parauniversitar.

4. Efektet financiare, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për periudhën prill-korrik 2006, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006” për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave për vitin 2006.

5. Vendimi nr.601, datë 17.11.2000 i Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për dhënien e pagës së trembëdhjetë të punonjësve mësimorë të sistemin parauniversitar”, të ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 prill 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË

Emërtimi		Paga mujore				
		Paga individuale			Shtesa e profesionit	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Totali
		1	2	3	4	5= (1+2+3+4)
1	Drejtor i shkollës së mesme Përgjegjës poligoni Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë Drejtor në shkollat me probleme të larta mendore Drejtor i konvikteve	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	21574	
2	Zëvendësdyrejtor i shkollës së mesme Përgjegjës i bazës prodhuese Zëvendësdyrejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë Zëvendësdyrejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë Zëvendësdyrejtor në shkollat me probleme të larta mendore Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	18147	
3	Drejtor i shkollës 8-vjeçare	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	17658	
4	Drejtor i shkollës fillore, klasa I-IV Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive Zëvendësdyrejtor i shkollës 8-vjeçare Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	15505	

	të Fëmijëve					
5	Drejtor i kopshtit me ushqim	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	13137	
6	Drejtor i kopshtit pa ushqim	2	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	11226	
7	Mësues në shkollat e mesme Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë. Mësues në institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë. Mësues në shkollat me probleme të larta mendore	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	15167	
8	Mësues në shkollat 8-vjeçare, klasa I-VIII Edukator konvikti Kujdestar konvikti Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	12510	
9	Edukator në kopsht fëmijësh	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	9447	
10	Mësues	2	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	10750	
11	Mësues	3	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	10750	
12	Edukator në kopsht fëmijësh	3	2% e P.G.	5% 10% 20%	9087	
13	Edukator në kopsht fëmijësh	2	2% e P.G.	5% 10% 20%	9087	

Grupi	Paga në lekë
1	10050
2	8950
3	7000
4	4500

Lidhja nr.3

SHPËRBLIMI MUJOR PËR PUNONJËSIT MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR, QË PUNOJNË LARG VENDBANIMIT

Mësuesit që punojnë larg vendbanimit të tyre marrin shpërblim si vijon:

- Kur punojnë brenda rrethit të tyre por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre deri në 1500 (një mijë e pesë qind) lekë në muaj, kur nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre deri në 4375 (katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj.

- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre, në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë deri në 5875 (pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj kur punojnë në qytet dhe në qendër të rrethit, dhe deri në 7250 (shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë në muaj kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.

- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit, në rrethet Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd deri në 4375 (katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj kur punojnë në qytet dhe në qendër të rrethit, dhe deri në 5875 (pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.

- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit në rrethet e tjera, deri në 3000 (tre mijë) lekë në muaj, kur punojnë në qytet dhe në qendër të rrethit, dhe deri në 4375 (katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.

VENDIM

Nr.231, datë 19.4.2006

PËR KOMPENSIMIN NË VLERË TË USHQIMIT TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 21 të ligjit nr.8321, datë 2.4.1998 "Për Policinë e Burgjeve", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e Policisë së Burgjeve trajtohen me kompensimin ushqimor në vlerë, sipas racionit bazë ushqimor, për vaktin e drekës, për ditët efektive të punës, sipas normës ushqimore, të miratuar me vendimin nr.160, datë 9.7.1975 të Këshillit të Ministrave.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë.

3. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.232, datë 19.4.2006

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SHQIPTARE PËR TË

DREJTAT E AUTORIT (ZSHDA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 117 të ligjit nr.9380, datë 24.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. STATUSI DHE OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË ZYRËS SHQIPTARE PËR TË DREJTAT E AUTORIT (ZSHDA)

1. Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), është institucion qendror, me statusin e personit juridik publik, në varësi të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me seli në Tiranë. ZSHDA-ja ka vulën dhe logon e vet, të cilat miratohen nga titullari, në përputhje me vendimin nr.474, datë 10.7.2003 “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë”.

2. ZSHDA-ja e ushtron veprimtarinë në mbështetje dhe në zbatim të Kushtetutës, të legjislacionit shqiptar për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të në dispozitat e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe në konventat e marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

3. ZSHDA-ja ka si objekt të veprimtarisë mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera, të lidhura me të, nga subjektet, persona fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike, shkencore.

II. ZYRA RAJONALE E SË DREJTËS SË AUTORIT

4. Për përmbushjen e funksioneve, pranë çdo qarku, krijohen zyrat rajonale të së drejtës së autorit (më tej ZRDA), të cilat janë struktura në varësi administrative të ZSHDA-së. ZRDA-ja ka vulën dhe logon e vet, në përputhje me përcaktimin e bërë në pikën 1 të këtij vendimi, ku shtohen fjalët “Zyra rajonale për të drejtat e autorit dhe qarku...”.

5. ZRDA-ja, nëpërmjet inspektorëve, kontrollon autorizimet dhe lejet përkatëse, të lëshuara nga autorët, titullarët e të drejtave të autorëve apo të agjencive të administrimit kolektiv, ndaj përdoruesve të pronësisë artistike, kulturore a shkencore, dhe vendosin gjobat, në përputhje me nenin 130 të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera, të lidhura me të”, brenda kufijve administrative të qarkut, ku ushtron veprimtarinë zyra rajonale e të drejtave të autorit.

III. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ZSHDA-SË

6. Shqyrton dhe regjistron çdo aplikim për regjistrim të së drejtës së autorit dhe të drejtave, të lidhura me të, për subjektin aplikues, autor apo titullar i të drejtave të autorit mbi një vepër.

7. Depoziton të gjitha aplikimet, regjistrimet dhe ndryshimet e të drejtave të autorit, të cilat i mban në bazën e të dhënave, që administrohen në Regjistrin e të Drejtave të Autorit, një regjistër ky dokumentar, elektronik.

8. Certifikon çdo marrëveshje apo kontratë, të lidhur dhe/apo të ndryshuar, ndërmjet palëve, subjekte të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, ku objekt i kontratës janë të drejtat mbi veprën dhe/ose kalimin e të drejtave pasurore mbi veprën, në rast përdorimi, shfrytëzimi, riprodhimi, shpërndarjeje apo përcjelljeje në publik, në përputhje me nenet 45/1, 47 e 51/3. Për zbatimin sa më efektiv të këtij ligji pranë ZSHDA-së, regjistrohen dhe certifikohen të gjitha kontratat për kalimin, në formën ekskluzive, të të drejtave pasurore mbi një vepër, të çfarëdolloji, duke i pajisur me pullën artistike të gjitha kopjet e veprave, të cilat janë rezultat i riprodhimit nga një kopje origjinale.

9. Ofron shërbime të specializuara, kundrejt tarifave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për çdo subjekt të interesuar, bën ekspertizën dhe jep vlerësimin me shkrim për çdo rast konflikti ndërmjet palëve, që kanë objekt të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të.

10. Përcakton, me kërkesë të autorit, shpërbimin për kalimin e të drejtave pasurore mbi veprën, ndërmjet autorit dhe/ose titullarit të të drejtave të autorit dhe palës tjetër kontraktuese, sipas objektit të kontratës, në rast se ky shpërbim nuk është parashikuar shprehimisht në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, sipas neneve 34/2 e 68/3 të ligjit në fuqi.

11. Shqyrton dhe jep shpjegim përfundimtar, me shkrim, për kërkesën e autorit, për veprën që

pretendohet se është përdorur, shfrytëzuar, ndryshuar, riprodhuar, shpërndarë apo përcjellë në publik, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

12. Shqyrton mosmarrëveshjet për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të në përputhje me nenin 104 të ligjit.

13. Cakton ekspertët e së drejtës së autorit pranë organeve gjyqësore, sipas fushave përkatëse, mbështetur në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

14. Mbikëqyr veprimtarinë dhe zbatimin e detyrimeve ligjore të agjencive të administrimit kolektiv të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të, dhe nëse vëren shkelje të detyrimeve ligjore, vepron në përputhje me nenin 116 të ligjit.

15. Shqyrton kërkesat e të interesuarve për t’u licencuar në fushën e administrimit kolektiv të së drejtës së autorit, bën kontrollin e dokumentacionit të paraqitur, zhvillon hetim të plotë administrativ dhe i paraqet Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dosjen e aplikantit, relacionin dhe mendimin e vet për përmbushjen ose jo të kushteve për t’u pajisur me licencë, në përputhje me nenin 108 të ligjit.

16. Rregullon dhe certifikon çdo kontratë të lidhur ndërmjet autorit/autorëve apo titullarit/ve të të drejtave të autorit dhe agjencisë së administrimit kolektiv të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të.

17. Vendos pullën artistike të ZSHDA-së dhe depoziton një kopje origjinale të mbajtësit fonografik/videogramit ose të mjetit të ngjashëm me të për riprodhimin e tyre, si dhe ushtron kontroll për respektimin e të drejtave të autorit, e prodhuesve apo shpërndarësve të kopjeve të autorizuar të fonogrameve, në përputhje me nenin 60 të ligjit.

18. Bashkëpunon me organet tatimore, doganore, gjyqësore dhe me institucionet e tjera publike, si dhe me organizatat private, që përfaqësojnë përdoruesit e ndryshëm të pronësinë artistike, kulturore dhe shkencore për ato çështje që paraqesin interes të përbashkët për mënyrën e respektimit dhe të zbatimit të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

19. Vendos marrëdhënie bashkëpunimi me organizata të ndryshme dhe institucione homologe jashtë vendit.

20. Propozon për përmirësimin e akteve, ligjore dhe nënligjore, në fushën e së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të dhe ia paraqet Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

21. Boton buletin periodik, ku jep informacione, analiza, studime dhe çështje të tjera të së drejtës së autorit dhe vë në dijeni publikun nëpërmjet *web site*-it për veprimtarinë dhe misionin që ka në fushën e të drejtave të autorit.

IV. STRUKTURA DHE ORGANIKA E ZSHDA-SË

22. Struktura dhe organika e ZSHDA-së miratohen me urdhër të Kryeministrit dhe me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

23. Titullari i ZSHDA-së është drejtori i kësaj zyre. Ai drejton veprimtarinë e ZSHDA-së në përputhje me këtë vendim dhe me kërkesat e ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, si dhe përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët.

24. Emërimi, lirimi dhe shkarkimi nga detyra i drejtorit të zyrës bëhen në përputhje me kushtet, kriteret dhe procedurat e përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

25. Kandidati, që konkurren apo emërohet në detyrën e drejtorit të ZSHDA-së, nuk duhet të ketë konflikt interesi në kuptim të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

26. Marrëdhëniet juridike të punës, të drejtat dhe detyrimet, si dhe procedurat e rekrutimit të nëpunësve të ZSHDA-së mbështeten në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe në aktet e tjera nënligjore në fuqi.

V. ORGANIZIMI FINANCIAR

27. ZSHDA-ja është institucion buxhetor. Buxheti i zyrës miratohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve menjëherë pas miratimit nga Kuvendi të ligjit për buxhetin vjetor.

28. ZSHDA-ja siguron të ardhura nga ofrimi i shërbimeve të specializuara, që ofron ndaj subjekteve të ndryshme, sipas tarifave të miratuara për këto shërbime, me vendim të Këshillit të Ministrave, dhe i përdor ato në përputhje me aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi.

29. ZSHDA-ja mund të marrë dhurime dhe financime nga organizma brenda dhe jashtë vendit, që nuk vendosin detyrimin për kthimin e tyre, të cilat hyjnë në buxhetin e zyrës dhe përdoren në përputhje me destinacionin e dhënë.

VI. REGJISTRIMI, APLIKIMI DHE PROCEDURAT PÛRKATËSE

30. Regjistri i të drejtave të autorit është elektronik dhe dokumentar, i krijuar për të mbajtur të dhënat e të gjitha aplikimeve, regjistrimeve, depozitave, certifikimeve dhe të çdo veprimi të ndërmarrë nga ZSHDA-ja.

31. Regjistri dhe çdo informacion ruhen dhe administrohen nga ZSHDA-ja në përputhje me ligjin “Për arkivat” dhe u vihen në dispozicion palëve të interesuara në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit publik në administratën shtetërore”.

32. Regjistri i së drejtës së autorit është i organizuar në klasa administrative dhe indeksohet në bazë të qëllimit dhe aplikimit në ZSHDA.

33. Zyra, nëpërmjet strukturës përgjegjëse, vë në dispozicion të aplikantëve/subjekteve të interesuara, pa pagesë, formularët-tip të aplikimit, të miratuar sipas qëllimit të aplikimit, në përputhje me klasën administrative.

34. Në formularët-tip të aplikimit përcaktohet, në çdo rast, edhe tarifa përkatëse për shërbimin, që kërkohet të ofrohet nga zyra.

35. Aplikanti (autori/ët, përfaqësuesit e tyre ligjorë, trashëgimtarët, titullarët e të drejtave të tyre apo agjencitë e administrimit kolektiv) plotëson formularin përkatës dhe ia paraqet ZSHDA-së, të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” dhe rregulloren e brendshme të zyrës, si dhe çdo informacion tjetër, të vlerësuar nga ZSHDA-ja të vlefshëm, për veprën dhe të drejtat mbi të.

36. Klasifikimi administrativ dhe indeksimi i regjistrit të së drejtës së autorit bëhen, si më poshtë vijon:

a) Regjistrimi i së drejtës së autorit dhe i të drejtave të lidhura me të.

b) Regjistrimi i kontratave dhe marrëveshjeve, që kanë objekt të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të;

c) Regjistrimi i agjencive të administrimit kolektiv të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të, të licencuara, si dhe çdo informacion që këto agjenci detyrohen të paraqesin në ZSHDA.

ç) Certifikimi i çdo të drejte të regjistruar dhe/ose i çdo kalimi të të drejtave, sipas kërkesave të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

d) Depozitimi, sipas nenit 60/2 të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

37. Në çdo rast të parashikuar në pikën 36 të këtij vendimi, strukturat përgjegjëse të ZSHDA-së bëjnë indeksimin e të dhënave për çdo ndryshim të ndodhur, refuzimin apo çregjistrimin e bërë nga subjektet dhe të pasqyruar në regjistrin e ZSHDA-së.

38. Indeksimi i të dhënave në regjistrin e së drejtës së autorit rrit por nuk zë vendin e të dhënave përmbajtëse në regjistrimin e mëparshëm.

39. Dokumentet e paraqitura nga aplikantët për regjistrimin e së drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të origjinalit, të tri muajve të fundit.

40. Deklaratat që depozitohen nga autorët nga përfaqësuesit e tyre ligjorë apo titullarët e të drejtave, duhet të jenë origjinale dhe të nënshkruara nga vetë këto subjekte.

41. Çdo kontratë apo marrëveshje ndërmjet palëve, që ka për objekt të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, e cila për të qenë e vlefshme regjistrohet në ZSHDA, në mbështetje të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, duhet të jetë origjinale dhe e nënshkruar nga palët.

42. Struktura përgjegjëse që shqyrton aplikimin, dokumentacionin dhe të dhënat e kërkuara në këtë kre, ka të drejtë të refuzojë regjistrimin e së drejtës së autorit dhe e të drejtave të tjera të lidhura

me të dhe të njoftojë me shkrim aplikantin për këtë refuzim.

43. ZSHDA-ja refuzon regjistrimin dhe certifikimin e çdo kontrate, e cila është bërë në kundërshtim me nenet 40 dhe 60 të ligjit, si dhe me ato dispozita ligjore në fuqi, që përcaktojnë depozitimin e detyruar të kopjes origjinale të veprës artistike, kulturore a shkencore.

44. Ankimi për refuzimin e këtij regjistrimi bëhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

VII. CERTIFIKIMI DHE VENDOSJA E PULLAVE

45. Certifikata e lëshuar për regjistrimin e të drejtave të autorit dhe vendosja e pullës së duhur dëshmojnë regjistrimin e një të drejte autori, që gëzon mbrojtje në mbështetje të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

46. Certifikimi bëhet nga struktura përgjegjëse e ZSHDA-së dhe nënshkruhet nga drejtori i zyrës ndaj titullarëve të regjistruar të së drejtës së autorit, që dëshmojnë ndaj të tretëve të drejtat e tyre të regjistruara.

47. Certifikata përmban të dhënat e bëra në aplikim, së bashku me numrin dhe datën e regjistrimit.

48. Data e regjistrimit të së drejtës së autorit është data kur aplikimi dhe tarifa janë depozituar për regjistrim në Zyrën Shqiptare të të Drejtave të Autorit.

49. Certifikimi i marrëveshjeve apo kontratave të lidhura ndërmjet autorit/eve, përfaqësuesve të tyre ligjorë apo titullarëve të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të dhe palës tjetër kontraktuese, për të përfituar (shfrytëzuar, shpërndarë, transmetuar, përcjellë në publik) këto të drejta, bëhet pasi kjo marrëveshje/kontratë është hartuar dhe nënshkruar në përputhje me ligjin dhe pasi është regjistruar në regjistrin e së drejtës së autorit dhe pas pagesës së tarifës përkatëse.

50. Kjo certifikatë apo kopje e certifikuar, e lëshuar, është e pranueshme në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë si provë e së drejtës së autorit, pa përjashtuar prova të tjera, që vërtetohen dhe mund të pranohen për të demonstruar të drejtën e autorit në një proces civil.

51. Vendosja e pullës artistike nga ZSHDA-ja është një akt i domosdoshëm. Çdo prodhim i kopjes private duhet të ketë identifikimin e prodhuesit me shenjën e tij mbrojtëse “P”, të deklaruar pranë ZSHDA-së. Botuesi/prodhuesi i kopjes private, për çdo prodhim/riprodhim, duhet të jetë i pajisur me autorizim nga titullari/ët e të drejtave të autorit apo agjencitë e administrimit kolektiv, si dhe çdo prodhim apo çdo kopje private, që hyn nga jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, duhet të pajiset me pullën e ZSHDA-së. Kjo pullë duhet të ketë të gjitha elementet e sigurisë dhe mund të prodhohet, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë, me garancitë e duhura.

VIII. VENDOSJA E GJOBAVE DHE SHQYRTIMI I ANKIMIMEVE

52. Inspektorët e së drejtës së autorit, në zbatim të kompetencave që u jep ligji nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, vendosin gjobat ndaj subjekteve, që me veprimet apo mosveprimet e tyre kryejnë kundërvajtje administrative dhe përgatisin, në mënyrë periodike, raportin për drejtorin e ZSHDA-së.

53. Subjektet e ndëshkuara administrativisht kanë të drejtën e ankimit, drejtuar ZSHDA-së, ndaj vendosjes së gjobës nga inspektorët, duke respektuar afatet dhe procedurat e ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” dhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

54. Struktura përgjegjëse për shqyrtimin e ankimeve të gjobave caktohet nga titullari i ZSHDA-së dhe procedura për shqyrtimin, marrjen e vendimit për lënien në fuqi ose jo të masës ndëshkimore përcaktohet në rregulloren e brendshme të ZSHDA-së.

55. Vendimi përfundimtar i dhënë nga ZSHDA-ja, pas shqyrtimit të ankimit administrativ, si dhe të gjitha procedurat, të dhënat apo depozitat e administruara për objektin e këtyre procedurave, regjistrohen dhe administrohen në përputhje me klasat administrative në regjistrin e të drejtave të autorit.

56. ZSHDA-ja vë në dispozicion të dhënat që zotëron dhe administron, për inspektim publik nga palët e interesuara, subjekte të ligjit, për aq sa interesat e këtyre subjekteve lidhen me regjistrimet e së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të, si dhe vë në dispozicion të organeve

gjyqësore, me kërkesë të këtyre të fundit, çdo të dhënë që kërkohej për ato çështje që kanë objekt cenimin e këtyre të drejtave.

IX. DISPOZITA TË FUNDIT

57. Efektet financiare, për ngritjen dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, për vitin 2006, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i miratuar po për këtë vit.

58. Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.233, datë 19.4.2006

PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE, PËR VITIN 2006

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 87 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, për vitin 2006, në shumën 190 635 475 (një qind e nëntëdhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë, sipas strukturës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
Lidhja nr.1

STRUKTURA E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2006

Nr.	Emërtimi	Lekë
	Shpenzime gjithsej	190 635 475 00
1	Paga	46 000 000 00
2	Kontributi i sigurimeve shoqërore	9 000 000 00
3	Materiale	4 500 000 00
4	Shërbime	18 500 000 00
5	Investime	112 635 475 00

VENDIM
Nr.1, datë 31.1.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Thimjo Kondi

Kryetar

Nikoleta Kita	anëtare
Kristaq Ngjela	anëtar
Spiro Spiro	anëtar
Agron A.Lamaj	anëtar
Ylvi Myrtja	anëtar
Artan Hoxha	anëtar
Perikli Zaharia	anëtar
Shpresa Beçaj	anëtare
Evjeni Sinoimeri	anëtare
Irma Bala	anëtare
Besnik Imeraj	anëtar
Ardian Dvorani	anëtar

në seancën gjyqësore të datës 31.01.2006, morën në shqyrtim çështjen civile nr.11/2 Akti që i përket:

PADITËS: SHOQËRIA "SERVCOM" sh.a., përfaqësuar nga juristi A.Olldashi.

TË PADITUR: KKK PRONAVE, BASHKIA SARANDË, në mungesë.

SPIRO ZËRI, STAVRI ZËRI, përfaqësuar nga Av.Amalia Zëri.

PERSONA TË TRETË: MUHAMET HATIA, SHKËLQIM AKULLI

ADEM DRAÇI, HEKTOR QIRJAQI, përfaqësuar nga Av.Arqile Nini e Besnik Kacurri.

OBJEKTI: Rishikim i vendimit civil nr.199, datë 26.03.2001 të Gjykatës së Rrethit Sarandë, lënë në fuqi me vendimin nr.374, datë 17.07.2001 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe lënë në fuqi me vendimin nr.483, datë 04.03.2003 të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE:Neni 494 /a i Kodit të Procedurës Civile

Gjykata e Shkallës së Parë Sarandë, me vendimin nr.199, datë 26.03.2001, ka vendosur:

-Pranimin e kërkesëpadisë së palës paditëse shoqëria "Servcom" sh.a. Fier, si dhe të personave të tretë: Muhamet Hatia, Shkëlqim Akulli, Hektor Qirjazi, Adem Draçi, si vijon më poshtë.

- Anulimin e vendimit nr.278, datë 08.02.1996 të KK Pronave pranë bashkisë Sarandë, përsa i përket njohjes së ish-pronësisë të trashëgimtarëve Jorgji e Vasil Zëri, mbi një ndërtesë dykatëshe të ndodhur në qytetin e Sarandës ish-zyrat e naftës, sot pronë e palës paditëse shoqëria "Servcom" sh.a. Fier, si dhe të sipërfaqes së truallit nën dhe në funksion të objektit prej 271,6 m².

Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr.374, datë 17.07.2001, ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit nr.199, datë 26.03.2001 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Sarandë, në lidhje me pranimin e padisë së palës paditëse shoqëria "Servcom" sh.a. Fier, për anulimin e pjesshëm të vendimit nr.278, datë 08.02.1996 të KKK Pronave Sarandë sipas dispozitivit.

- Prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit në lidhje me personat e tretë Muhamet Hatia, Shkëlqim Akulli, Hektor Qirjaqi e Adem Draçi.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.483, datë 04.03.2003 ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit nr.374, datë 17.07.2001 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

Pala e interesuar Spiro Zëri, në bazë të nenit 494/a të Kodit të Procedurës Civile, ka kërkuar rishikimin e vendimit të formës së prerë, duke parashtruar këto shkaqe:

- Kanë zbuluar si prova të reja shkresore hartën e vitit 1935 të qytetit të Sarandës (marrë nga arkivi qendror më datë 11.09.2003), në të cilën figuron ndërtesa e cila ka qenë në posedim të të paditurve kundrejt qirasë. Ndërsa ndërtesa dykatëshe objekt gjykimi duket se nuk ka ekzistuar në këto vite në atë vend.

- Në hartën e vitit 1938 të qytetit të Sarandës, figuron ndërtesa në fjalë dhe jo ndërtesa e cila është prishur më 1935 sipas dokumenteve arkivore. Kjo provon se godina objekt gjykimi, nuk është ajo e mbajtur me qira nga pala e paditur, por është godina që figuron në hartën e vitit 1938.

- Po kështu, si provë të re shkresore ka paraqitur Ligjin e Mbretit Zog, datë 21.09.1937 për shtyrjen e regjistrimeve të përgjithshme të ndërtesave e të tokës, ndërtimeve të vitit 31-37 për vitin 1938 e në vazhdim (marrë nga Biblioteka Kombëtare si ekstrakt më datë 04.09.2003). Me këtë provohet se ndërtesa objekt gjykimi është ndërtuar para vitit 1938, por është regjistruar më vonë kur është bërë transkriptimi i pronës në vitin 1939.

Kolegji Civil i Gjykatës Lartë, me vendimin nr.17, datë 10.03.2004, ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së kërkesit Spiro Zëri për rishikim vendimi.

- Prishjen e vendimit nr.199, datë 26.03.2001 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, lënien në fuqi të vendimit nr.374, datë 17.07.2001 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, lënë në fuqi me vendimin nr.483, datë 04.03.2003 të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Sarandë.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr.17, datë 18.07.2005, ka vendosur:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.17, datë 10.03.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

Kryetari i Gjykatës së Lartë me vendimin datë 11.01.2006 ka vendosur:

- Kalimin për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara për efekt të ndryshimit të praktikës gjyqësore të çështjes me palë "Servcom" sh.a. Fier, Spiro Zëri, Hektor Qirjaqi, Muhamet Hatia, Shkëlqim Akulli, Adem Draçi e Komisioni i Kthimit e Kompensimit të Pronave; me objekt rishikim vendimi të formës së prerë.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga anëtarët Irma Bala e Nikoleta Kita dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Kërkesa e kërkuarit Spiro Zëri, për rishikimin e vendimit civil nr.199, datë 26.03.2001 të Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, lënë në fuqi me vendimin nr.374, datë 17.07.2001 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe me vendimin nr.683, datë 04.03.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, është e pabazuar në ligj dhe nuk pranohet.

Rezulton se, me vendimin e gjykatës së shkallës së parë të sipërpërmendur ka marrë formë të prerë, që kërkohet të rishikohet, është vendosur: "Pranimi i kërkesëpadisë së palës paditëse shoqërisë "Servcom" sh.a. Fier".

Anulimin e vendimit nr.278, datë 08.02.1996 të KK Pronave, pranë bashkisë Sarandë, përse i përket njohjes së-ish pronësisë së trashëgimtarëve të Jorgji e Vasil Zërit, mbi një ndërtesë dykatëshe të ndodhur në qytetin e Sarandës, ish-zyrat e naftës, sot pronë e palës paditëse shoqëria "Servcom" sh.a. Fier, si dhe të sipërfaqes së truallit nën dhe në funksion të objektit".

Vendimi i sipërm është lënë në fuqi pas shqyrtimit nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë.

Gjatë këtij procesi gjykimi, siç kanë konkluduar gjykatat është vërtetuar se, me vendimin nr.272, datë 08.12.1996 të KK Pronave pranë bashkisë Sarandë, në favor të palës së paditur Spiro dhe Stavri Zëri, ndër të tjera është njohur pronësia dhe kthyer një godinë dykatëshe, si dhe një sipërfaqe trualli prej 1457 m² në qytetin e Sarandës me kufizimet përkatëse:

Objekti në fjalë dhe sipërfaqja funksionale, ndërkohë, ishte në administrim të palës paditëse shoqërisë "Servcom" sh.a., krijuar pas rristurimit të ndërmarrjes shtetërore "Albpetrol", me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pikërisht këtë vendim të KK Pronave e ka kundërshtuar, me padinë e ngritur në atë gjykim, pala paditëse "Servcom" sh.a., duke pretenduar se objekti (godina dykatëshe) nuk ka qenë asnjëherë në pronësi të trashëgimtarëve të të paditurve "Zëri", dokumentet shkresore të administruara në gjykim, nuk kanë provuar pronësinë e paditësve mbi ndërtimin, por qenien e godinës kapital themeltar i shoqërisë krijuar si rrjedhojë e procesit të rristurimit.

Në prapësimet e tyre të paditurit kanë pretenduar se vendimi i KKK Pronave është i ligjshëm, objekti dykatësh ka qenë në pronësi të trashëgimtarëve të tyre dhe është përdorur gjatë gjithë kohës, deri kur është shtetëzuar pa shpërblim në vitin 1946.

Nga gjykatat që kanë shqyrtuar çështjen, është konkluduar se nga të gjitha aktet shkresore të administruara e analizuara si prova, nuk ka rezultuar asnjë dokument shkresor, që të vërtetojë pronësinë e trashëgimtarëve të palës së paditur "Zëri" mbi godinën dykatëshe dhe sipërfaqen funksionale të saj objekt mosmarrëveshje. Arsyetohet se, dokumentet shkresore të administruara, kanë sqaruar se "Shoqëria Tabaqi e ortakë", administratori i së cilës pretendohet se ka qenë njëri nga

trashëgimlënësit ka përdorur godinën për ushtrimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë kundrejt marrëdhënieve juridike të qirasë dhe në asnjë mënyrë në pronësi. Po kështu, nga gjykatat është konkluduar se vendimi nr.727, datë 11.10.1994 i Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, i cili ka vërtetuar pronësinë e të paditurve mbi godinën është një vendim deklarativ dhe nuk mbështet pretendimet e palëve për qenien pronare mbi sendin.

Rezulton se, analizuar si prova harta e vitit 1938 (relievi i Sarandës) e akte të tjera shoqëruese, nga arkiva dhe zyra e urbanistikës, si dhe provat shkresore që palët kanë mbështetur pretendimet e tyre në lidhje me pronësinë mbi godinën dhe është konkluduar se godina në fjalë ka qenë ekzistuese pas këtij viti, në kundërshtim sa pretendohet se ajo ka qenë e tillë pas vitit 1939, vit në të cilin është provuar se është regjistruar në radhorin e transkriptimeve në favor të trashëgimlënësve "Zëri", sipërfaqja e tokës prej 1457 m², njohur e kthyer nga KKK Pronave, bashkë me godinën.

Kërkuesi Spiro Zëri, më datë 02.10.2003, ka paraqitur para Gjykatës së Lartë kërkesën për rishikim bazuar në nenin 494/a, 496, 497 dhe 498/2 të Kodit të Procedurës Civile.

Sipas nenit 494/a të Kodit të Procedurës Civile, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë kur:

a) *"Zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihenin nga pala gjatë shqyrtimit të saj".*

Në mbështetje të kërkesës për rishikim dhe bazës ligjore të referuar, pala e interesuar i ka paraqitur gjykatës këto dokumente:

a) Hartën e vitit 1935 të qytetit Sarandë (marrë nga arkivi qendror më 11.03.2003). Sipas palës, në këtë hartë vërtetohet se ndërtesa e pasqyruar ka qenë në posedim të tyre (trashëgimlënësve) kundrejt qirasë, ndërsa provon se në këtë vit ndërtesa dykatëshe objekt gjykimi nuk ka ekzistuar. Pra konfirmohet se godina objekt gjykimi nuk është ajo e mbajtur me qira, ndërsa është prishur, por është godina që figuron në vitin 1938.

b) Ligjin e "Mbretit Zog", datë 21.09.1937, për shtyrjen e regjistrimeve të përgjithshme të ndërtesave të viteve "31-37" për vitin 1938, "e në vazhdim" (marrë nga Biblioteka Kombëtare) e si ekstrakt, më 04.09.2003), me të cilin pala mbështet pretendimin se ndërtesa është ngritur para vitit 1938, por, regjistrimi për shkak të këtij ligji, është bërë më vonë, gjë që është në kundërshtim me konkluzionet që kanë pranuar gjykatat se godina i përket vitit 1939.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1704, datë 10.03.2004, pasi ka shqyrtuar në dhomën e këshillimit çështjen, bazuar në nenin 498/2 të Kodit të Procedurës Civile, ka konkluduar se provat e paraqitura nga pala përbëjnë shkak për rishikimin e vendimeve dhe ka vendosur:

"Pranimin e kërkesës së kërkuesit Spiro Zëri për rishikim vendimi. Prishjen e vendimeve nr.199, datë 26.03.2001 të Gjykatës së Rrethit Sarandë, lënë në fuqi me vendimin nr.374, datë 17.07.2001 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, lënë në fuqi me vendimin nr.483, datë 04.03.2003 të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Sarandë".

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.17 datë 18.07.2005 ka vendosur:

"Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.17, datë 10.03.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë"

Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, duke u shprehur ndër të tjera se:

"Shkaqet e parashtruara nga kërkuesi për proces të parregullt kanë të bëjnë me mungesën e komunikimit të kërkesës për rishikim të çështjes në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve. Këto dy shkelje të pretenduara janë të lidhura e të ndërruara nga njëra-tjetra dhe kanë të bëjnë me standardet e caktuara për një proces të rregullt në drejtim të së drejtës së mbrojtjes së pjesëmarrjes në gjykim dhe parimit të kontradiktoritetit. Në kushtet normale të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, sipas përmbajtjes së nenit 447 të Kodit të Procedurës Civile, është e detyrueshme që palës së interesuar t'i njoftohet më parë kërkesa e paraqitur nga pala tjetër.

- Kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës dhe e nenit 6 të Konventës Europiane të të drejtave të njeriut të marra në tërësi kanë për qëllim që t'i garantojnë kujtdo që pretendon se i janë shkelur të drejtat e njohura në Kushtetutë, në radhë të parë ndjekjen e çështjes në gjykatë, pjesëmarrjen në gjykim.

- Në kuptimin e standardeve të vendosura nga Kushtetuta dhe Konventa vlerësohet se në shqyrtimin e çështjes nga gjykatat e sistemit gjyqësor, duhet të mos preken kriteret e procesit të rregullt, duke dalluar qartë kompetencat e dhomës së këshillimit nga njëra anë dhe seancën gjyqësore

nga ana tjetër. Nga referimi në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, del qartë se dhoma e këshillimit vendos për mospranimin e rekursit ose të kërkesës për rishikim, por nuk mund të vendosë prishjen e vendimeve, aq më tepër pa njoftuar palën që ka fituar gjyqin. Nga përmbajtja e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, që kanë të bëjnë me kërkesat e rishikimeve del se shqyrtimi në dhomën e këshillimit lidhet me mospranimin e tyre për t'u shqyrtuar. Në të kundërtën kur këto kritere përcaktohen, nuk mund të vendoset pranimi i kërkesës për rishikim jashtë seancës gjyqësore dhe pa pranimin e palëve.

- Rifillimi i procesit gjyqësor nga e para pas një periudhe të caktuar kohe nga marrja formë të prerë të vendimit, pa u dhënë mundësi të barabarta palëve për t'u shprehur, del haptazi jashtë kufijve të procesit të rregullt në kuptimin e Kushtetutës dhe Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut. Çdo provë e paraqitur nga pala që pretendon se mund të çojë në rihapjen e procesit gjyqësor duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit sipas parimit të kontradiktoritetit. Seanca e hapur gjyqësore përbën një tipar themelor të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Sipas nenit 6/1 të Konventës karakteri i hapur e pretendimeve mbrojt palët ndërgjyqëse kundrejt ushtrimit të së drejtës në fshehtësi dhe pa mbikëqyrje publike.

- Bazuar në këto argumente, kërkesa për rishikim është një mjet ankimi dhe duhet t'i njoftohet palës tjetër sipas rregullave të përgjithshme.

- E drejta për një proces të rregullt përfshin gjithashtu nocionin se të dyja palët në proces kanë të drejtë të kenë informacion mbi faktet dhe argumentet e palës kundërshtare të kenë njohuri edhe për komentet mbi provat e nxjerra.

- Nga ana tjetër duke marrë parasysh natyrën e shqyrtimit të çështjes në rastet e rishikimit, e cila ka të bëjë jo vetëm me konstatimin e fakteve apo edhe me vlerësimin e tyre (shkronja a, b, e, neni 494 të Kodit të Procedurës Civile), atëherë ky vlerësim duhet të bëhet nga gjykata, pasi të ketë zbatuar parimin e kontradiktoritetit. Ky rast ka rëndësi, pasi nuk mund të prishen vendimet në dhomën e këshillimit duke prekur standardet e procesit të rregullt ligjor".

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në disa çështje të tjera të shqyrtuara para daljes së vendimit të lartpërmendur të Gjykatës Kushtetuese, kur ka konkluduar se janë shkaqe të rishikimit, ka vendosur në dhomën e këshillimit, bazuar në nenin 498/2 të Kodit të Procedurës Civile, pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të formës së prerë dhe, po në dhomën e këshillimit, ka vendosur prishjen e vendimeve të dhëna për çështjet përkatëse dhe dërgimin e çështjes për rigjykim.

Kjo praktikë është unifikuar në vendimin nr.8, datë 24.03.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që i përket kërkesit Mantho Kukumi, me objekt rishikim vendimi.

Në arsyetim të këtij vendimi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, janë shprehur si më poshtë:

"Kur vendoset që kërkesa për rishikim të pranohet, Kolegji Civil nuk shprehet për pabazueshmërinë apo ligjshmërinë e vendimit, por e prish atë për shkak të vënies në dyshim të tij për një nga shkaqet e reja të krijuara pas marrjes formë të prerë të vendimit i cili kërkohet të rishikohet. Nisur nga argumentimi i sipërm, mospjesëmarrja e palëve nuk cenon të drejtën e tyre për një proces të rregullt gjyqësor, në themel të të cilit qëndron dhënia e mundësive të barabarta të gjitha palëve për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur. Në të kundërt, po të pranohej thirrja e palëve dhe pjesëmarrja e tyre gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, dashur pa dashur do të impononte debatin mes palëve, hyrjen e tyre e gjykatës me vlerësimin e problemeve që kanë të bëjnë me themelin dhe bazueshmërinë e çështjes".

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se **"kërkesa për rishikimin e një vendimi civil të formës së prerë shqyrtohet nga Kolegji Civil në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve"**.

Sa më lart rezulton se precedenti i pranuar nga Gjykata e Lartë është i kundërt me qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese në interpretim të nenit 6 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut dhe në zbatim të precedentëve (case law) të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut.

Për rrjedhojë, për efekt të ndryshimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, lidhur me sa sipër, Kryetari i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 141/2 të Kushtetutës dhe të nenit 14/c të ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë", ka vendosur:

"Kalimin për shqyrtimin në Kolegjet e Bashkuara për efekt të ndryshimit të praktikës gjyqësore të çështjes me palë "Servcom" sh.a. Fier, Spiro Zëri, Hektor Qirjaqi, Muhamet Hatia, Shkëlqim Akulli, Adem Draçi e Komisioni i Kthimit e i Kompensimit të Pronave me objekt rishikim

vendimi të formës së prerë".

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në zbatim të nenit 42 të Kushtetutës, nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, të precedentëve (*case law*) të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, nenit 447 të Kodit të Procedurës Civile, që kanë si qëllim t'i garantojnë kujtdo që pretendon se janë shkelur të drejtat e njohura në Kushtetutë dhe në ligj, në radhë të parë ndjekjen e çështjes në gjykatë, t'i garantojnë atyre pjesëmarrjen në gjykim, përfitimin nga garancitë procedurale që u ofrohen palëve në një proces të rregullt gjyqësor, në kuptimin e standardeve të vendosura nga Kushtetuta dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, gjykimi se seanca e hapur gjyqësore përbën një tipar thelbësor të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Garantimi i kësaj të drejte përbën një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, në themel të të cilit qëndron dhënia e mundësive të barabarta të gjitha palëve për ndjekjen e mbrojtjen e çështjes në gjykatë, "barazinë e armëve", duke i siguruar mundësitë përkatëse për të parashtruar pretendimet e saj, në kushtet që nuk e vënë atë në gjendje shumë më pak të favorshme sesa palën e kundërt. Në raste të tilla, standardi minimal që duhet t'i garantohet palës respektive është shansi i barabartë për të qenë në një proces gjyqësor për të cilën gjyqfituesi është akoma nën përfytyrimin e një të drejte të fituar me vendimin e formës së prerë.

Sa sipër, bazuar në përmbajtjen e dispozitave të Kodit Civil, që rregullojnë institutin e rishikimit të vendimit, neni 494 e vijues, del se shqyrtimi në dhomën e këshillimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konsiderohet shqyrtim paraprak i çështjes dhe jo seancë dëgjimore. Në këtë shqyrtim Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në zbatim të nenit 482 të Kodit të Procedurës Civile, vendos mospranimin e kërkesës për rishikim, kur nuk përmbushen kriteret ligjore për t'i "hapur rrugën" rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Në këtë rast, gjykata nuk cenon vendimin gjyqësor të formës së prerë, objekt rishikimi të marrë në respektim të standardeve të një procesi ligjor dhe që ka zgjidhur përfundimisht çështjen.

Në të kundërt, kur nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit konstatohet se faktet e paraqitura nga pala që kërkon rishikimin mund të jenë shkaqe që neni 494 germa a, b, c, d, e, lejojnë për të kërkuar rishikimin e një vendimi të formës së prerë, çështja duhet të kalohet në seancë të hapur gjyqësore për vlerësimin e shkaqeve të rishikimit.

Sa sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për efekt të ndryshimit të praktikës gjyqësore, **konkludojnë se, nëse në dhomën e këshillimit Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konstaton se faktet e paraqitura nga pala e interesuar, mund të jenë shkaqe për rishikim të një vendimi të formës së prerë, çështja nuk vendoset në dhomë këshillimi, por në seancë gjyqësore duke njoftuar palët për të marrë pjesë në gjykim.**

Gjykimi në seancë gjyqësore në këtë rast nuk është një gjykim themeli, por një seancë dëgjimore, ku secila nga palët pjesëmarrëse në gjykim, pasi gjykata të zbatojë parimin e kontradiktoritetit, paraqet argumente rreth shkaqeve që ligji kërkon për rishikimin.

Sa sipër, në seancën gjyqësore të datës 31.01.2006, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me pjesëmarrjen e palëve, pasi dëgjuan argumentet e tyre në lidhje me kërkesën për rishikim vendimi dhe bazuar në shkaqet që pala e interesuar i ka paraqitur gjykatës, vlerësojnë se kërkesa nuk është e mbështetur në ligj dhe nuk duhet pranuar. Sa më poshtë:

Rishikimi i vendimeve është një mjet i jashtëzakonshëm për goditjen e vendimeve civile që ka për qëllim rishikimin e çështjes së përfunduar me vendime të formës së prerë, për shkak se vendimi i gjykatës është i gabuar përse i përket çmuarjes së faktit. Ky gabim i të çmuarit të faktit, sipas nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të rrjedhë ose për shkak se nuk janë marrë parasysh në dhënien e vendimit rrethana të cilat nuk dihen më parë prej gjykatës, por që dalin më vonë, të cilat sikur të dihen, do t'i jepnin çështjes një zgjidhje të ndryshme (494/a), ose vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara etj. (neni 494/c/d,e, të Kodit të Procedurës Civile).

Kërkuesi Spiro Zëri e ka bazuar kërkesën për rishikim neni 485/a të Kodit të Procedurës Civile.

Sa i përket shkakut të parashikuar nga germa "a" e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, rrethanat e reja apo provat e reja, të zbuluara pas marrjes formë të prerë të vendimit, duhet të mos kishte mundësi që të dihen në kohën e gjykimit të çështjes nga pala, si dhe, për pasojë, nga gjykata jo vetëm për shkak të veprimit të anës kundërshtarë, por edhe për çdo shkak tjetër që nuk rrjedh nga faji i palës që kërkon të mbështesë të drejtat e tij mbi provën ose rrethanën e zbuluar.

Pra rrethana ose prova e zbuluar duhet të plotësojë këto kushte:

a) Të ketë rëndësi esenciale për zgjidhjen e çështjes, të tillë që sikur gjykata të kishte qenë në dijeni të saj vendimi që do të jepte do të ishte i ndryshëm nga ai që ka dhënë.

b) Të jetë zbuluar rishtazi, të mos ketë qenë as që mund të ishte në dijeni të kërkuesit në kohën e dhënies së vendimit nga ana e gjykatës.

c) Të jetë një rrethanë në lidhje me një fakt që nuk është pranuar nga ana e gjykatës.

Harta e emërtuar "pjesë nga relievi i Sarandës i vitit 1935" marrë nga Arkivi Qendror i Ndërtimit, më datë 11.09.1993, paraqitur si shkak i zbuluar i ri, që ka rëndësi për çështjen dhe mbi të cilin mbështetet kërkesa për rishikim vendimi, vlerësohet se nuk plotëson kriteret e sipërpërmendura të provës apo të rrethanës së re, që parashikon neni 494/a të Kodit të Procedurës Civile.

Tërësia e provave shkresore të administruara e analizuar nga gjykatat si vërtetim pronësie, i paraqitur nga trashëgimtarët Zëri, dokumentet shkresore marrë nga Arkivi Qendror Tiranë etj., të analizuar nga gjykatat, nuk kanë provuar pronësinë e palëve Spiro e Stavri Zëri mbi objektin "godinë dykatëshe" në qytetin e Sarandës, fituar me një nga mënyrat që ligji kërkon, për fitimin e pronësisë mbi sendet e paluajtshme.

Pra rëndësia dhe fuqia provuese e hartës si dokument i paraqitur nuk është e tillë që, për mungesë të çmuarjes së saj si fakt, gjykata të ketë dhënë një vendim të gabuar të ndryshëm nga ai që ka dhënë.

Harta e paraqitur nuk rezulton të jetë e tillë që, nuk ka ekzistuar gjatë gjykimit, pavarësisht nga data kur është marrë nga arkivi, nuk është një rrethanë e ndryshuar më vonë dhe as rrethanë që nuk është pranuar nga ana e gjykatës, për pasojë nuk përbën shkak për rishikimin e vendimit.

Gjithashtu ligji i "Mbretit Zog" datë 21.09.1937 "Për shtyrjen e regjistrimeve të përgjithshme të ndërtesave të viteve", nuk përbën rrethanë të re që plotëson kriteret e përmendura më sipër, e tillë që, nuk ka ekzistuar në kohën e shqyrtimit të çështjes, apo një provë e re në favor të pretendimeve të kërkuesit "Zëri" në lidhje me pronësinë, mbi godinën ose të ketë dalë pas dhënies së vendimit përfundimtar, që të përbente rrethanë të re për një zgjidhje të ndryshme të çështjes nga zgjidhja e dhënë.

Si konkluzion, gjykohet se faktet e paraqitura nga kërkuesi "Zëri" nuk janë shkaqe që kërkon neni 494 i Kodit të Procedurës Civile për t'i hapur rrugën një gjykimi të ri të çështjes pas marrjes së formës së prerë të vendimit që kërkohet të rishikohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, konform nenit 498 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 14/c të ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSËN:

Mospranimin e kërkesës së kërkuesit Spiro Zëri për rishikimin e vendimit nr.199, datë 26.03.2001 lënë në fuqi me vendimin nr.374, datë 17.07.2001 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, lënë në fuqi me vendimin nr.483, datë 04.03.2003 të Gjykatës së Lartë.

Unifikimin e praktikës gjyqësore sipas vendimit të mësipërm.

Një kopje e vendimit dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Nikoleta Kita, Agron A.Lamaj, Ylvi Myrtja, Perikli Zaharia, Evjeni Sinoimeri, Irma Bala, Ardian Dvorani

MENDIMI I PAKICËS

Bashkohemi me mendimin e pakicës përsa i përket përfundimit të arritur për pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të formës së prerë. Ishte me vend që kjo kërkesë të pranohej, pasi, ashtu siç ka pranuar edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.1704, datë 10.03.2004,

kërkesa për rishikim përmban provë të re shkresore dhe rrethana të reja me rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen dhe nuk kishte mundësi të dihen kur është gjykuar çështja dhe është marrë vendimi për zgjidhjen e saj. Për këtë pakica ka dhënë argumente të sakta e të plota.

Përsa i përket ndryshimit të praktikës gjyqësore të vendosur me vendimin unifikues nr.8, datë 24.03.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bashkohemi me mendimin e shumicës. Gjykata Kushtetuese, pavarësisht nga fakti i tejkalimit të kufijve të juridiksionit të saj, si dhe nga fakti që ka marrë përsipër rolin e ligjvënësit duke ndryshuar kuptimin dhe përmbajtjen e normave të Kodit të Procedurës Civile, në vend që të shprehej për pakushtetutshmërinë e tyre, në themel ka dhënë një zgjidhje që nuk mund të mos pranohet.

Spiro Spiro, Shpresa Beçaj, Thimjo Kondi

MENDIM PAKICE

Gjyqtarët në pakicë janë të mendimit se në rastin në shqyrtim ka qenë vendi që kërkesa për rishikimin e vendimit të pranohej, pasi gjykatës i është paraqitur një provë e re shkresore me rëndësi për çështjen, e cila nuk ishte e ditur gjatë gjykimit nga pala kërkuese.

Rishikimi si institut i së drejtës civile është një mjet ankimi që gjen rregullim ligjor në pjesën e tretë të Kodit të Procedurës Civile. Në nenin 494 është përcaktuar se kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës, ndërkohë që neni 498/1 i Kodit të Procedurës Civile ka parashikuar rastet kur vendoset mospranimi i kërkesës. Duke analizuar kërkesat e kësaj dispozite të lidhura me çështjen në gjykim, del qartë që kërkesa e Spiro Zërit duhej pranuar si e mbështetur në ligj.

Kërkesa për rishikimin e vendimit civil nr.199, datë 26.03.2001 të Gjykatës së Rrethit Sarandë bazohet në germën “a” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, pasi pretendohet se janë zbuluar rrethana dhe prova të reja me shkresë, të cilat kanë rëndësi për çështjen dhe që gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk dihen nga pala kërkuese. Si provë e re me shkresë është paraqitur një hartë e vitit 1935 e qytetit të Sarandës, lëshuar nga Arkivi Qendror në datën 11.09.2003, në të cilën figuron një ndërtesë, fabrikë vaji, që ka qenë në posedim të të paditurve kundrejt qirasë, por që nuk është ajo objekt konflikti material në këtë gjykim. Pretendimi i kërkuësve lidhur me përmbajtjen e kësaj harte është se ata nëpërmjet saj provojnë së ndërtesa objekti i këtij gjykimi është ndërtuar pas vitit 1935 dhe është e ndryshme me atë që është regjistruar në vitin 1938 dhe që figuron në hartën e këtij viti. Në rast se edhe një ekspertim teknik do të provonte origjinën e hartës dhe do të konkludonte, sikurse pretendohet lidhur me vendndodhjen e ndërtesës objekt gjykimi, atëherë çështja do të merrte tjetër zgjidhje nga ajo që i është dhënë me vendimin e formës së prerë nr.199, datë 26.03.2001.

Rrethana e re e paraqitur në kërkesën për rishikim nga ana e kërkuësit është edhe pamundësia që kanë pasur ata si ish-pronarë për të realizuar regjistrimin e pronës në kohën e duhur, për shkak të shtyrjes së afatit të regjistrimeve nga ligji i vitit 1937. Kjo rrethanë ishte e nevojshme t’i nënshtrohej shqyrtimit gjyqësor dhe e marrë në tërësi me provat e tjera, mund të çonte në ndryshimin e vendimit që kërkohet të rishikohet.

Pakica, pasi parashtroi shkaqet pse duhej pranuar kërkesa për rishikim, ka gjithashtu mendimin se vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka prishur vendimin nr.17, datë 10.03.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, është një vendim i marrë tej juridiksionit të asaj gjykate, e cila në rastin në shqyrtim ka vepruar si një gjykatë e sistemit gjyqësor.

Përpara se të argumentojmë këtë afirmim, është vendi që të sqarohet se ç’kuptohet me *juridiksion rishikues* të Gjykatës së Lartë sipas nenit 141 të Kushtetutës, pasi paqartësia lidhur me këtë, është edhe një nga shkaqet që kanë çuar në përfundime të gabuara të kuptimit të këtij juridiksionit të Gjykatës së Lartë.

Për herë të parë pas shfuqizimit të Kushtetutës të vitit 1976, me Ligjin për Dispozitat Kryesore Kushtetuese të miratuara me ligjin nr.7561, datë 29.04.1992, Gjykata e Lartë u quajt Gjykatë Kasacioni dhe kësaj gjykate iu përcaktua juridiksioni, ndër të tjera, i verifikimit të zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Në nenin 7 parashikohej se “...Gjykata e Kasacionit shqyrton vetëm bazën ligjore të vendimeve gjyqësore që i paraqiten në rrugë kundërshtimi, ose që i tërheq vetë”. Pra, ajo gjykatë

verifikonte nëse ishte zbatuar drejt ose jo ligji nga gjykata më e ulët dhe nuk verifikonte problemet që lidheshin me provat dhe drejtësinë e vendimit bazuar mbi to. Mbi këtë rregullim kushtetues u hartuan edhe kodet e procedurave, përfshi atë të procedurës civile, në themel të të cilave, nëpërmjet rekursit në Gjykatën e Kasacionit, nuk mund të atakoheshin vendimet e formës së prerë për bazueshmërinë e tyre në prova. Pra, Gjykata e Lartë, me këto dispozita kushtetuese, u ndërtua dhe u transformua si një gjykatë ligji dhe jo fakti.

Në dallim nga ky realitet kushtetues, Kushtetuta e vitit 1998, ndryshoi përsëri emrin e kësaj gjykate nga Gjykatë Kasacioni, në Gjykatë të Lartë. Kjo jo për ndonjë shkak konvencional apo parapëlqimi të autorëve të hartimit të kësaj Kushtetute, por për një shkak thelbësor që lidhet me juridiksionin e kësaj gjykate. Në qoftë se në dispozitat kryesore kushtetuese përcaktohej se juridiksioni i Gjykatës së Lartë lidhur me vendimet e gjykatave më të ulëta kufizohej në verifikimin e zbatimit të ligjit prej tyre, pra Gjykatë Kasacioni, me nenin 141 të Kushtetutës aktuale, përcaktohet se kjo Gjykatë ka funksion rishikues ndaj vendimit të gjykatave më të ulëta, pa përcaktuar nëse ai kufizohet vetëm për problemet e ligjit.

Duke qenë kjo dispozitë e Kushtetutës e hapur për interpretim, ligjvënësi përcaktoi Gjykatën e Lartë si një gjykatë ligji dhe fakti me saktësimin, në dispozitat e Kodeve të Procedurës Civile dhe Penale, se në cilat raste kjo gjykatë funksionon si gjykatë ligji dhe në cilat si gjykatë fakti. **Kodi i Procedurës Civile njeh dy mjete reagimi për të kundërshtuar vendimet e formës së prerë të gjykatave. Rekursin, të cilin e lidh me shkaqe të moszbatimit apo zbatimit të gabuar të ligjit, neni 472, dhe rishikimin, i cili aplikohet për rrethana të faktit që rezultojnë të ndryshme me ato që janë shqyrtuar më parë nga gjykatat, të përcaktuar në mënyrë të shprehur si raste në nenin 494.**

Sikurse lehtësisht konstatohet, shndërrimi i emrit nga Gjykatë Kasacioni në Gjykatë të Lartë lidhet drejtpërdrejt me ndryshimin e juridiksionit të kësaj gjykate, duke i shtuar asaj, ndër të tjera, edhe të drejtën të verifikojë bazueshmërinë në fakt të vendimit të formës së prerë, veç të drejtës së verifikimit të zbatimit të ligjit prej gjykatave.

Aktualisht, si rekursi, ashtu edhe rishikimi i vendimit të formës së prerë janë dy mjete reagimi të barazvlefshme për efektet që pas sjellin, por të ndryshëm për shkaqet e parashtrimit të tyre.

Thënë kjo, pa dashur të hyjmë në shtjellime të detajuara të kuptimit të këtij mjeti ankimi tashmë në juridiksion të Gjykatës së Lartë, mendojmë se rastet e përdorimit të tij dhe procedura e shqyrtimit nga Gjykata e Lartë gjejnë interpretim të unifikuar me vendimin nr.8, datë 24.03.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të kësaj gjykate.

Pakica vlerëson se është rasti që të vihet në dukje dallimi mes juridiksionit të Gjykatës së Lartë dhe juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Sipas Kushtetutës, nenit 141/2, është Gjykata e Lartë që me Kolegjet e Bashkuara ka autoritetin e njehsimit dhe ndryshimit të praktikës gjyqësore lidhur me interpretimin e ligjit, ndërsa Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 124/1, ka autoritetin e interpretimit përfundimtar të Kushtetutës.

Gjykata e Lartë ka bërë interpretimin e saj për dispozitat e Kodit të Procedurës Civile lidhur me mënyrën e gjyqimit të kërkesës për rishikim të vendimit të formës së prerë, duke iu referuar dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile. Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese, edhe pse nuk godet drejtpërdrejt vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, e bën atë pa vlerë, duke konsideruar proces të parregullt ligjor mënyrën se si ka vepruar Kolegji Civil për shqyrtimin e kërkesës për rishikim në këtë gjykim. Kjo pasi ky Kolegj, për zgjidhjen e çështjes në fjalë, i është referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe vendimit unifikues që ka bërë interpretimin e këtyre dispozitave. Me këtë, Gjykata Kushtetuese ka zëvendësuar në fakt Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe ka detyruar tashmë këto kolegje të ndryshojnë kuptimin e ligjit, për pasojë zbatimin e tij, sikurse e interpreton atë Gjykata Kushtetuese, duke ndryshuar kështu praktikën gjyqësore.

Po të shkohet më tej, rezulton se vetë Gjykata Kushtetuese nuk ka qenë konsekuente në qëndrimin që mban lidhur me juridiksionin e saj. Në një çështje analoge, ku është vënë në diskutim interpretimi i dispozitave të Kodit të Procedurës Civile lidhur me kërkesën për rishikim, ajo gjykatë, me vendimin e saj nr.19, datë 23.12.2004, ka arsyetuar me të drejtë se: *“Interpretimi i ligjit duke përcaktuar përmbajtjen e tij është atribut i organeve që zbatojnë atë. Duke u nisur nga ky parim, del se edhe sqarimi i kuptimit të çdo dispozite të Kodit të Procedurës Civile dhe raporti i saj me dispozitat e tjera të përafërta me të për zbatimin e tyre në gjykimin e çështjeve, është në kompetencë të gjykatave të sistemit gjyqësor. Gjykata e Lartë, duke ushtruar kompetencat e veta, ka interpretuar dispozitat e*

Kodit të Procedurës Civile dhe ka arritur në përfundimin se fillimi i afatit të kërkesë ... nga marrja formë të prerë të vendimit, nuk cenon parimet procedurale dhe as përmbajtjen e institutit të rishikimi ...”.

Marrja përsipër nga Gjykata Kushtetuese e interpretimit më të lartë të ligjit, duke vazhduar më tej edhe me përcaktimin prej saj të procedurave që duhet të ndjekë Gjykata e Lartë në shqyrtimin e kërkesave të rishikimit, kur këto procedura nuk i parashikon në mënyrë të shprehur ligji, por mund të rezultojnë në interpretim të tij, mendojmë se jo vetëm është jashtë natyrës së kësaj gjykate, por është edhe një ndërhyrje e hapur në autoritetin dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe shkelje e Kushtetutës nga vetë Gjykata Kushtetuese.

Nga ana tjetër, pranimi i një procedure të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese për gjykimin e kërkesës për rishikim të vendimeve civile të formës së prerë, e vë Gjykatën e Lartë përpara dy standardeve të ndryshme për zbatimin e ligjit procedural, krahasuar me gjykimin e kërkesës për rishikim ndaj vendimeve penale të formës së prerë. Për këtë të fundit, ligji ka qenë eksplisit për procedurën që duhet ndjekur për shqyrtimin e rishikimit, që është i ndryshëm me atë që kërkohet nga Gjykata Kushtetuese të ndiqet në procesin civil.

Kemi mendimin se në eventualitetin se Gjykata Kushtetuese vlerëson si antikushtetuese procedurën që ndiqet në zbatimin e ligjit, ajo, në ushtrim të juridiksionit të saj, duhet të verifikojë dhe të deklarojë papajtueshmërinë e vetë ligjit me Kushtetutën. Pa bërë më parë këtë, ajo nuk ka juridiksion të vlerësojë si proces të parregullt marrjen e një vendimi që bazohet në një procedurë të përcaktuar me ligj.

Pakica ka gjithashtu mendimin se është vendi të theksojë edhe një moment të rëndësishëm i cili ka të bëjë me një tejkallim tjetër të Gjykatës Kushtetuese në ushtrimin e juridiksionit të saj. Sipas nenit 131 germa “f” të Kushtetutës që i jep juridiksion kësaj gjykate të verifikojë lidhur me zbatimin e një procesi të rregullt ligjor, përcaktohet se ajo vendos për *“gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave”*. Jo pa qëllim, ju referuam më sipër evoluimit të juridiksionit të Gjykatës së Lartë, nga gjykatë ligji në gjykatë rishikimi. Kur kjo gjykatë vendos të rishikohet vendimi si për shkak të ligjit, ashtu edhe për shkak të faktit dhe prish vendimet e gjykatave tërësisht ose pjesërisht duke dërgon çështjen për rigjykim, nuk jep një vendim përfundimtar. Kështu, Gjykata e Lartë konstaton shkelje të ligjit nga pikëpamja e zbatimit të tij, ose për shkak të fakteve nga gjykatat më të ulëta dhe me vendimin e saj urdhëron, në të dy rastet, të ribëhet gjykimi i çështjes.

Marrë për bazë sa më sipër, është lehtësisht e konstatueshme se këto lloj vendimesh të Gjykatës së Lartë nuk janë vendime përfundimtare dhe palëve nuk u janë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre, pasi çështja është akoma në gjykim nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Mendojmë se është në kundërshtim me Kushtetutën ndërhyrja e Gjykatës Kushtetuese gjatë procedurave të shqyrtimit të çështjes nga gjykatat. Asnjë germë e Kushtetutës nuk e bën kompetentë këtë Gjykatë që të marrë vendime për çështje të papërfunduara akoma nga juridiksioni gjyqësor. Në të kundërt, Gjykata Kushtetuese do ta kthente veten në një gjykatë të dytë të Lartë, duke i dhënë të drejtë vetes, siç ka ndodhur në rastin në shqyrtim, të bëhet pjesë e juridiksionit gjyqësor, të cilës ajo nuk i përket.

Besnik Imeraj, Kristaq Ngjela, Artan Hoxha

VENDIM
Nr.3, datë 3.2.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbëra nga:

Nikoleta Kita	Kryetare
Kristaq Ngjela	anëtar
Artan Hoxha	anëtar
Evjeni Sinoimeri	anëtare
Besnik Imeraj	anëtar
Spiro Spiro	anëtar
Irma Bala	anëtare
Perikli Zaharia	anëtar
Shpresa Beçaj	anëtare
Agron A.Lamaj	anëtar
Ylvi Myrtja	anëtar
Ardian Dvorani	anëtar

në seancën gjyqësore të datës 01.02.2006 dhe 03.02.2006, shqyrtuan çështjen civile që i përket:

PADITËS: Resul Sulejmani, përfaqësuar nga av.Viktor Ikonomi.

E PADITUR: 1. Hajria Mullai, përfaqësuar nga av.Edmond Hicka.

2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

OBJEKTI:

Kthimin e sendit, kati përdhe, çregjistrimin e tij në ZRP Paluajtshme nga emri i së paditurës Hajrie Mullai, nxjerrjen e saj jashtë nga sipërfaqja e banesës e pushtuar me dhunë pa qenë pronare, detyrimin e saj të paguajë dëmin e shkaktuar dhe qiranë deri ditën që do të lirojë objektin.

BAZA LIGJORE: Nenet 295, 290/d, 298, 231, 193/h të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2641, datë 11.06.2003, ka vendosur:

Pranimin e padisë së bërë nga Resul Sulejmani.

Detyrimin e palës së paditur Hajrie Mullai të kthejë katin përdhe, si dhe çregjistrimin në hipoteke të pronës. Refuzimin e kërkesëpadisë për detyrimin e së paditurës Harie Mullai për të paguar dëmin e shkaktuar dhe qiranë.

Mbi ankimin e së paditurës çështja është shqyrtuar **në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr.650, datë 21.05.2004,** ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.1641, datë 11.06.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë së ngritur nga paditësi Resul Sulejmani.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka paraqitur rekurs paditësi Resul Sulejmani, i cili kërkon prishjen e tij e lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke parashtruar se:

- Në vendimin e marrë Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka marrë parasysh faktet e dokumentuara. Ajo ka lejuar shkelje të rënda procedurale duke mos iu përgjigjur kërkesave të padisë, gjë që vjen në kundërshtim me kërkesat e neneve 6, 10, 20, 29 e 309 të Kodit të Procedurës Civile.

- Në vendim janë deformuar faktet. Nuk është e vërtetë që kam kërkuar kthimin e sendit si pronar i vetëm sikurse thuhet në vendim, por si bashkëpronar i tij.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.2775/640 të regjistrimit themeltar, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore, me arsyetimin se lidhur me faktin juridik ka pasur gjykime të mëparshme, ku paditësi nuk ka qenë palë dhe shtron para Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë praktikën gjyqësore në këto drejtime:

Çfarë vlere ka një vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për fakte të caktuara dhe të zgjidhura nga gjykata për çështje të tjera edhe pse nuk konsiderohen çështje të gjykuara.

Çfarë vlere ka kontrata e dhurimit e lidhur midis bashkëshortëve në raport me bashkëpronësinë? A konsiderohet sendi i dhuruar në këtë rast pronë ekskluzive e njërit bashkëshort apo me këtë duhet kuptuar se bashkëshorti tjetër jep pëlqimin e plotë për çdo veprim që bashkëshorti përfitues kryen me atë pronë përfshi dhe tjetërsimin e saj, apo ky është një veprim juridik fiktiv që nuk pa sjell asnjë pasojë lidhur me statusin e bashkëpronësisë të pronës së bashkëshortëve pavarësisht disponimit që njeri bashkëshort bën në favor të bashkëshortit tjetër.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve **Kristaq Ngjela dhe Artan Hoxha**, përfaqësuesin e paditësit, avokatin Viktor Ikonimi, i cili kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë e lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuesin e së paditurës, avokatin Edmond Hicka, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe pasi e analizuan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Vendimi nr.650, datë 21.05.2004 i Gjykatës së Apelit Tiranë është i bazuar në ligj e për pasojë duhet të lihet në fuqi.

Paditësi Resul Sulejmani, me një padi rivendikimi, ka kërkuar kthimin e sendit pronë e tij dhe çregjistrimin e saj nga ZRP Paluajtshme nga emri i së paditurës Hajrie Mullai në emrin e tij, detyrimin që e paditura t'i paguajë dëmin e shkaktuar nga mbajtja padrejtësisht e sendit dhe pagimin e qirasë deri sa të lirojë sendin (banesën). Këtë padi ai e bazon mbi pretendimin e qenies bashkëpronar me bashkëshorten Dasamira Nakuçi, mbi pronën objekt konflikti.

Ka rezultuar nga aktet e administruara në gjykimin e çështjes, se paditësi, me kontratën e dhurimit datë 14.08.1982 të Hafza Saraçit, është bërë pronar mbi një shtëpi dykatëshe me dy dhoma e korridor në katin e parë, dy kuzhina në katin përdhe me korridor në mes dhe një aneks, shtëpi e veçantë në oborr njëkatëshe me dy dhoma, ndodhur në Tiranë, me kufij të përcaktuar.

Në datën 26.04.1988, paditësi ka marrë leje ndërtimi me vendim të komitetit ekzekutiv të KE-së së lagjes nr.4, për shtesa në këtë shtëpi në pronësi të tij dhe ka filluar të realizojë punimet. Paditësi është martuar me Dasamira Nakuçi më datë 01.02.1989 dhe me kontratën e dhurimit të datës 02.12.1995, lidhur para noterit me nr.2846 rep., i dhuron asaj “një aneks shtëpi e veçantë me oborr, njëkatëshe me dy dhoma, si dhe ndërtimet e reja të papërfunduara ngjitur me banesën ekzistuese”, Në këtë kontratë theksohet se Resul Suljemani ia dhuron bashkëshortes pronën e mësipërme, “...e cila bëhet pronë ekskluzive e saj për ta gëzuar, poseduar e disponuar sipas dëshirës dhe ajo bëhet pronare e vetme duke u zhveshur dhuruesi nga pronësia”.

Më pas, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dasamira Nakuçi ka vërtetuar faktin juridik të ndërtimit të shtëpisë, të cilën, me kontratën e datës 26.11.1996, ia ka shitur së paditurës Hajrie Mullai. Në këtë kontratë përcaktohet se shitësja i shet Hajrie Mullait katin përdhe të përbërë nga katër dhoma, dhomë gatimi, korridor, verandë, WC, të cilat e paditura i ka regjistruar në emrin e vet.

Paditësi pretendon se këtë shitje bashkëshortja e tij e ka bërë duke qenë e detyruar për të shlyer një detyrim financiar dhe se, nga ana tjetër, përsërit edhe në gjykim se shitja është bërë pa pëlqimin e tij. Duke ngritur këtë pretendim, paditësi kërkon kthimin e sendit pasi, sipas tij, shitja e bërë bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 87 të Kodit Civil, miratuar me ligjin nr.6340, datë 26.06.1981. Sipas këtij neni, “veprimet juridike të kryera nga cilido bashkëshort në lidhje me sendet e përbashkëta të tyre, janë të vlefshme edhe kur janë kryer pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër. Por tjetërsimi i pasurive të përbashkëta të paluajtshme duhet të bëhet me pëlqimin e të dy bashkëshortëve”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2641, datë 11.06.2003, ka pranuar pjesërisht padinë e paditësit Resul Sulejmani duke detyruar të paditurën Hajrie Mullai të kthejë katin përdhe, si dhe ka urdhëruar bërjen e çregjistrimit përkatës në ZRP Paluajtshme. Vendimit i mungon arsyetimi ligjor i shkaqeve që ajo gjykatë ka arritur në përfundimin e pranimit të padisë, por më tepër në të kryesisht përmendet historiku i kalimit të pronësisë tek e paditura Hajrie Mullai.

Duke ndryshuar këtë vendim dhe rrëzuar padinë, Gjykata e Apelit Tiranë arsyeton se vendimi i gjykatës së rrethit është i padrejtë, në zbatim të gabuar të ligjit material e procedural. Në vendim

theksohet se e paditura Hajrie Mullai është bërë pronare në bazë të një veprimi juridik civil të ligjshëm dhe sendin ajo e mban mbi bazën e atij veprimi. Më tej në vendimin e gjykatës së apelit arsyetohet se paditësi nuk është pronar i sendit për të cilin kërkon rivendikimin, pasi e ka humbur pronësinë duke ia dhuruar sendin bashkëshortes së tij.

Në vendimin e gjykatës së apelit theksohet edhe fakti se, lidhur me kontratën e shitblerjes midis Dasamira Nakuçi dhe Hajrie Mullait, Dasamira ka bërë kërkesëpadi duke kërkuar pavlefshmërinë e kontratës, padi e cila është rrëzuar. Kjo çështje është shqyrtuar edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat, me vendimin nr.84, datë 03.07.2001, kanë lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Padia e paditëses Dasamira Nakuçi në atë gjykim bazohej në pretendimin se e paditura Hajrie Mullai nuk e kishte paguar realisht vlerën e plotë të sendit të blerë prej saj dhe se veprimi juridik i shitjes nuk ishte kryer në përputhje me ligjin, pasi sendi ishte në bashkëpronësi bashkëshortore dhe për tjetërsimin e tij, nuk ishte marrë pëlqimi i bashkëshortit Resul Sulejmani. Duke lënë në fuqi vendimin për rrëzimin e padisë së Dasamira Nakuçi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arsyetojnë se pretendimet e saj se prona e shitur ka qenë në bashkëpronësi me bashkëshortin, ka qenë çështje fakti dhe provë të paraqitura prej saj e të vlerësuar nga gjykata e rrethit dhe e apelit të cilat nuk e kanë marrë në konsideratë këtë pretendim. Përderisa prona e shitur nuk është trajtuar në bashkëpronësi bashkëshortore, çmohet i panevojshëm pëlqimi i bashkëshortit të paditëses.

Bazuar në këto rrethana, Kolegjet e Bashkuara, për zgjidhjen e çështjes, vunë në diskutim dhe u përqendruan në faktin se çfarë vlere ka kontrata e dhurimit të lidhur midis bashkëshortëve në raport me bashkëpronësinë? A konsiderohet sendi i dhuruar në këtë rast pronë ekskluzive e njërit bashkëshort apo do të konsiderohet edhe në këtë rast se sendi i fituar kalon në bashkëpronësi ndërmjet bashkëshortëve, si çdo send i fituar pas lidhjes së martesës?

Në kushtet e legjislacionit aktual, bazuar në nenin 77 germa “b” të Kodit të Familjes, nuk ka dyshim se sendet e fituara me dhurim gjatë martesës bëjnë pjesë në pasurinë vetjake të bashkëshortit përfitues. Ky tekst ligjor, i interpretuar në mënyrë të zgjeruar, përfshin jo vetëm hipotezën e personit të tretë që disponon sende në favor të bashkëshortëve, por edhe ato raste kur bashkëshortët disponojnë sende në favor të njëri-tjetrit gjatë martesës.

Zgjidhja paraqitet më delikate pasi marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve, përfshirë edhe dhurimet ndërmjet tyre, kanë lindur përpara hyrjes në fuqi të Kodit të Familjes e për rrjedhojë, rregullimi i tyre ligjor bëhet nga dispozitat e Kodit Civil të vitit 1982, konkretisht neni 86 dhe 87 të tij.

Në kushtet kur dispozita e Kodit Civil parashikonte se çdo send i fituar gjatë martesës konsiderohej bashkëpronësi ndërmjet bashkëshortëve, ndodhur para faktit që ligji nuk bënte asnjë dallim për mënyrat e fitimit të pronësisë e, aq me pak, për subjektin që kalon pronësinë, në interpretim të ngushtë gramatikor të dispozitës mund të arrihej në përfundimin se edhe në rastin kur njëri bashkëshort i dhuron bashkëshortit tjetër një send gjatë martesës, sendi i fituar është në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve.

Kolegjet e Bashkuara janë të mendimit se zgjidhja e këtij rasti duhet bazuar në arsyetimin dhe interpretimin logjik, duke iu larguar interpretimit literal të neneve 86 e 87 të Kodit Civil të vitit 1982, i cili parashikonte lindjen e bashkëpronësisë duke u bazuar ekskluzivisht në faktin juridik të martesës. Në gjykimin tonë, ky tekst ligjor nuk mund të interpretohet i veçuar, por duhet trajtuar si pjesë e një tërësie sistematike e logjike e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike civile. Në këto rrethana, neni 87 duhet zbatuar në mënyrë harmonike dhe racionale, bazuar jo vetëm në parimet e lirisë kontraktore, por edhe në elementet thelbësore të kontratës së dhurimit të një sendi.

Për zgjidhjen e këtij rasti, kolegjet mbështesin arsyetimin në një argumentim të dyfishtë:

1. Nga njëra anë, duke u bazuar në elementet thelbësore të kontratës së dhurimit, konstatojmë se kjo marrëveshje, si veprim juridik i kategorisë së veprimeve pa kundërshtpërblim, synon kalimin e një vlere pasurore në pronar tjetër, pa synuar tjetër ekuivalent, për fitimin e realizuar.

Në zbatim të nenit 12/2 143/3 të kodit të vjetër civil, për lidhjen e çdo kontrate, njëri nga elementet thelbësore të vlefshmërisë së saj është ekzistenca e një shkaku të ligjshëm, i cili përfaqëson elementin psikologjik, qëllimin që synon pala kontraktore në momentin që merr përsipër një detyrim juridik.

Pranohet unanimisht se shkaku i kontratës së dhurimit është qëllimi për t'i sjellë dobi ekonomike palës tjetër, pa ndjekur asnjë përfitim si shkëmbim (neni 304/1 i Kodit të vjetër Civil). Me

fjalë të tjera, disponimi i pasurisë në rastin e kontratës së dhurimit bëhet për shkak të shpirtit të bujarisë, *animus donandi*, pa pretenduar kundërshtpërblim për detyrimin e marrë përsipër.

Nëse do të pranohej kthimi i një pjese të sendit të dhuruar dhuruesit, do të ndryshonte shkaku i kontratës së dhurimit dhe do të vihej në dyshim vullneti i dhuruesit.

2. Nga ana tjetër, duhet theksuar se kontrata e dhurimit ka si elemente përbërëse palët kontraktore, vullnetet konkurrense të cilave çojnë në lidhjen e kontratës dhe lindjen e marrëdhënies juridike.

Marrëdhënia që lind si rezultat i kontratës së dhurimit, si çdo marrëdhënie tjetër juridike, ka dy palë: dhuruesin, në pozitë të debitorit të kësaj marrëdhënieje, dhe përfituesin e detyrimit, në cilësinë e kreditorit. Si rezultat i lidhjes së kontratës dhe bazuar në efektet që ajo sjell për palët, elementi pasuror kalon përfundimisht nga pasuri e dhuruesit në atë të përfituesit të dhurimit. Detyrimin të dhuruesit për kalimin e pronësisë së sendit, i korrespondon e drejta e përfituesit të dhurimit për të fituar pronësinë mbi këtë send.

Në këto rrethana, të pretendosh që dhuruesi kalon pronësinë mbi gjithë sendin e dhuruar dhe në të njëjtën kohë përfiton 1/2 pjesë të tij, duhet të pranosh që dhuruesi gëzon njëkohësisht cilësinë e debitorit dhe atë të kreditorit mbi të njëjtin detyrim, atë të kalimit të pronësisë mbi një send të paluajtshëm. Me fjalë të tjera, do të thotë t'i japësh mundësinë një subjekti të së drejtës të lidhë kontratë me veten e tij, gjë që nuk përfaqëson gjë tjetër veçse një *non sens* juridik.

Lidhur me rrethanat e faktit, është e rëndësishme të theksohet se pasuria e dhuruar nga paditësi bashkëshortes së tij nuk është fituar gjatë martesës, por ka qenë pronë ekskluzive e paditësit përpara lidhjes së martesës me bashkëshorten Dasamira Nakuçi.

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në këto konkluzione unifikuese të praktikës gjyqësore:

Në rastin e dhurimit ndërmjet bashkëshortëve të sendeve vetjake të bashkëshortit dhurues apo sende të bashkëpronësisë, sendi i dhuruar do të kalojë në pasurinë vetjake të bashkëshortit përfitues, e në këto rrethana, këto sende nuk bëjnë pjesë në bashkësinë (bashkëpronësinë) ndërmjet bashkëshortëve.

Nëse objekt i kontratës së dhurimit është kalimi i pronësisë së një sendi, bashkëshorti tjetër bëhet përfitues i të gjithë sendit i cili kalon në pasurinë e këtij të fundit. Në rastet kur objekt i dhurimit janë sende që bëjnë pjesë në bashkësinë ndërmjet bashkëshortëve, do të konsiderohet se objekt i dhurimit është pjesa ideale mbi sendet në bashkëpronësi, e cila pas lidhjes së kontratës së dhurimit bashkohet me pjesën ekzistuese që gëzonte bashkëshorti përfitues mbi sendin, duke u kthyer kështu në pasuri ekskluzive të këtij të fundit.

Titullar i sendit të dhuruar është vetëm bashkëshorti përfitues i dhurimit. Sendi i përfituar nuk bën pjesë në bashkëpronësinë bashkëshortore e, si të tillë, bashkëshorti pronar mund ta tjetërsojë i vetëm kundrejt çdo subjekti, pa marrë pëlqimin e bashkëshortit dhurues.

Në kushtet kur e paditura Hajrie Mullai e mban pronën në bazë të një veprimi juridik të ligjshëm, padia e paditësit Resul Sulejmani për kthimin e sendit nuk gjendet e bazuar në ligj dhe me të drejtë është rrëzuar nga gjykata e apelit. Paditësi, me kalimin e pronës bashkëshortes së tij, nuk është më pronar, e as bashkëpronar mbi atë pronë. Shitjen e sendit të paluajtshëm, Dasamira Nakuçi e ka bërë në ushtrim të të drejtave të saj të pronësisë dhe me vullnet të lirë të vërtetuar përpara noterit.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 485/a të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSËN:

Lënien në fuqi të vendimit nr.650, datë 21.05.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Njësimin e praktikës gjyqësore sikurse arsyetohet përcaktohet në këtë vendim.

Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi që njëson praktikën gjyqësore.

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të pronarit z.Nevruz Riza Huta.

Subjekti kërkuar është bashkia Gramsh. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personin që preket nga ky shpronësim. Vënia në dijeni ka të bëjë me sipërfaqen që shpronësohet 200 m², apartamentin 46.6 m² dhe dru frutor.

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1-javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personi që ka emrin, ka të drejtë të paraqesë pretendimet e tij të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Brendshme.

Fatura, sipas formatit të mësipërm, t'i dërgohet për likuidim bashkisë Gramsh.

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS TË LAGJES DËLLINJË NË BASHKINË GRAMSH

Nr.	Lloji i pronës që do të shpronësohet	Njësia e matjes	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera në lekë	Emri i pronarit
1	Truall	m ²	200	2157.8	431560	Nevruz Riza Huta
2	Apartament	m ²	46.6	13137.6	612212	Nevruz Riza Huta
3	Dru frutor				136440	Nevruz Riza Huta
	Nga këto:					
a	Kumbulla	copë	10		16600	
b	Pjeshkë	copë	15		23920	
c	Kajsi	copë	8		11960	
d	Fiq	copë	14		18510	
e	Ullinj	copë	1		13500	
f	Ftonj	copë	2		3200	
g	Hereke	copë	35		48750	
	Shuma				1180212	
Vlera e shpronësimit, miratuar me vendim të këshillit të bashkisë nr.7 datë 1.3.2006 dhe aktmarrëveshjes datë 13.4.2006 së nënshkruar ndërmjet kryetarit të bashkisë Gramsh dhe z.Nevruz Huta, qytetari që shpronësohet.					1100000	Nevruz Riza Huta

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-eksponitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 4.5.2006
Doli nga shtypi më 10.5.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë